



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 23/18
Prishtinë, më 25.04.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajçi, Naser Osmani, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontiq, Mërgim Lushtaku, Dardan Molliqaj dhe Blerim Kuçi.

Pjesëmarrës të ftuar: Valon Prestreshi - Kryetar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (tutje: AKK), Fatime Haziri- Anëtare e AKK-së, Ramadan Gashi-Drejtor Ekzekutiv i Agjensisë për Ndihmë Juridike Falas (tutje: ANJF), Anita Kalanderi - Drejtoreshë e Departamentit Juridik të ANJF-së, Daut Morina - Drejtor i Administratës Qëndrore të KPMSH-së, Miran Zeneli - Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje: KPMSH), Hajzer Salihu - Anëtar i KPMSH, Shkëmb Manaj - Kryetar i KPMSH, Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu-Drejtor i Administratës së Kuvendit dhe Istret Azemi-Drejtor i Buxhetit dhe Pagesave të Kuvendit.

Pjesëmarrës tjerë: Shkëlqim Xhema nga Zyra Kombëtare e Auditimit, Alban Bajrami - Praktikant nga Kuvendi i Kosovës, Violeta Sfarça nga Innovation Media, Donika Osmani nga Ekonomia Online, Albulena Avdiu nga Ekonomia Sot, Beadin Sylja nga Kosova Press dhe Mentor Hyseni nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli, Luljeta Krasniqi dhe Eliza Hyseni(praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i komisionit – Lumir Abdixhiku (tutje: kryetari).

R e n d i i d i t ë s :

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjensisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës Civil të Kosovës për vitin 2017;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017;**

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për Liritë Fetare dhe amendamenteve të komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione;
7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën dhe amendamenteve të komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017

Kryetari - në bazë të nenit 28 paragrafi 1.13 ligji për mbrojtjen e konkurrencës Autoritetit Kosovar i Konkurrencës financohet nga buxheti i Kosovës dhe si rrjedhojë i përgjigjet Kuvendit për shpenzimin e buxhetit në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Valon Prestreshi – foli për punën e AKK-së, për sfidat dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Z. Prestreshi theksoi se buxheti i ndarë për AKK-në ishte 243.517 euro dhe i shpenzuar 224.000 euro apo 92% he kemi pasur suficit prej 19.355 apo 8%. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 100% , mallra dhe shërbime 73% , shpenzimet komunale 76.3%. AKK-ja duke i shfrytëzuar të gjitha hapsirat ligjore, financiare dhe strategjike të fuqizimit të procedurave dhe kapaciteteve humane ka arritur që ta kompletoj legjislacionin sekondar i përcaktuar me ligjin për mbrojtjen e konkurrencës. Për hartimin e këtij legjislacioni sekondar, Autoriteti ka shpenzuar 3,833 Euro. AKK-ja, përkatësisht departamenti për mbikëqyrjen e tregut ka 5 inspektorë drejtues të cilët duhet të mbulojnë tregun gjeografik të Republikës së Kosovës dhe me këtë numër të vogël të inspektorëve është e pamundur fizikisht të monitorohet dhe inspektohet i tërë tregu. AKK-ja ka kërkuar nga Ministria e Financave që ta bëjë rritjen e buxhetit dhe ta bëjë lejimin e rekrutimit të stafit ku këtë kërkesë ja ka dërguar edhe Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe për fat të mirë kjo kërkesë është aprovuar nga ju, ndërsa tek mallrat dhe shërbimet në buxhetin e Autoritetit kemi kërkuar që të ketë ngritje sistematike buxhetore në përputhje me ngritjen e aktiviteteve të Autoritetit. Për herë të parë një institucion publik ka konstatuar gjendjen në homologimin e automjetve nëse kemi monopol të pastër , ku Ministria e Infrastrukturës ka lidhur marrëveshje 10 vjeçare me Eurolab Sh.P.K , poashtu për herë të parë pasqyrohet një progres për institucionin tonë.

Kryetari - pyeti a mund të bëni një prezantim për çfarë udhëzimi administrativ bëhet fjalë që ka nxit kaq shumë reagim edhe te institucionet e BE-së edhe te institucionet e Kosovës, a bëhet fjalë për vazhdimin e monopolit që e kemi pas deri tani, dhe në qoftë se është i njëjti rast çka pritni nga ne që mund të bëjmë në këtë drejtim?

Valon Prestreshi – theksoi se në momentin e ardhjes sonë si Bord në vitin 2016, jemi ballafaquar menjëherë me ankesën e drejtpërdrejtë të GAF-it për homologimin e automjeteve, një kontratë 10 vjeçare siç e potencova dhe më herët. Ministria e Infrastrukturës e ka vendos në diskutim publik një udhëzim të ri administrativ për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për homologimin e mjeteve rrugore dhe unë kam qenë në Bruksel ku edhe atje është ngritur çështja se çfarë do të veprojmë në lidhje me këtë dukuri të këtij monopoli. Ne kemi analizuar ligjin dhe kemi dhënë mendimin tonë se ky udhëzim administrativ dhe nenet e caktuara shpie në sjellje antikonkurrese dhe ka potencial të ç'rregullojë tregun përkatës, ne kemi sugjeruar që të veprojë sipas mendimit tonë profesional dhe nuk kemi marrë përgjigje. Fatëkeqsisht ne kemi marrë informatë se ky udhëzim është nënshkruar nga MI-ja

duke mos e respektuar mendimin profesional të AKK-së. Kam kontaktuar me avokatin e popullit dhe ekziston mundësia që të atakohet në Gjykatën Kushtetuese në të kundërtën do të ishte mire që Komisioni ta ngrit këtë çështje në debat parlamentar.

Kryetari – pyeti a vazhdon praktika e deritanishme e monopolit në homologim ku i gjithë obligimi kryhet prej një kompanie të vetme me këtë udhëzim administrativ?

Valon Prestreshi - ligji i ri për automjetet e ka liberalizuar tregun dhe gjithëmonë potencohet në shumës jo në njëjës e ky udhëzim administrativ është vetëm trashje e monopolit të mëtutjeshëm të homologimit, nuk ka asnjë kompani tjetër që mundet me e përballu këtë udhëzim administrativ dhe për më tepër ky udhëzim do të jetë i përhershëm.

Naser Osmani – theksoi se çështja e monopolit të homologimit të automjeteve duhet të thuhet gjërat më preciz, ku formulimi i kontratës duhet të jetë në atë mënyrë i punuar që e ka vështirë dikush me ndërhy dhe asnjë ligj dhe asnjë udhëzim administrativ nuk mundet me aprovu këtë kontratë. Një çështje tjetër që më intereson është në lidhje me të hyrat ku keni paraqit vetëm të hyrat nga taksat administrative, ne asnjëherë nuk e shohim që ju e keni fitu ndonjë lëndë ?

Enver Hoti - ju thatë se kur e keni marrë mandatin keni has në vështirësi të mëdha, ju thatë që keni pas lëndë të parashtruara dua të di cilat janë dhe çfarë përmbajnë?

Safete Hadërgjonaj – një çështje që dua t'ia them drejtuesit të këtij institucioni, pra kryetarit të AKK-së, se ju jeni një kryetar i një institucioni mjaft të rëndësishëm dhe pse tek ne nuk konsiderohet si shumë i rëndësishëm, faktikisht është njëri ndër komisionet më të rëndësishme sepse reflekton direkt në zhvillimin ekonomik, në konkurrencë , në zhvillimin e mirë, në funksionimin e mirë të institucioneve shtetërore. Prandaj, ti më së paku duhet me qenë politik dhe mos me pas qasje politike gjatë raportimit në Komision. Raportin e punës së AKK-së e shqyrton Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri dhe për çështjen që ka të bëjë jashtë financave kanë të bëjnë ata, mirëpo edhe atij Komisioni nuk mundesh ti me ja sugjeru çka duhet me veprue si Komision, me kërku debat apo interpelancë në seancën parlamentare.

Unë jam shumë e interesuar që aty ku ka monopol vërtetë ta luani rolin të cilin ju ka dhënë ligji dhe të bëni punën maksimale që të evitoni monopolin të cilat ekzistojnë në Kosovë. Përpos te homologimi, a ka monopol diku tjetër dhe çka keni ndërmarrë ju si autoritet nëse ka monopol diku tjetër?

Sa i përket raportit financiar vërtetë ju nuk keni ndonjë buxhet aq të madh, mirëpo edhe këtë buxhet duhet me menaxhu mirë. Po shihet që nuk keni tejkalu shpenzimet, por më ka bërë përshtypje se si i keni shpenzuar me cent tek kategoria paga dhe mëditje? Tek shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve po e shoh që të planifikuara kanë qenë 1,907 Euro, të shpenzuara 1,974 euro e përqindja ka dalë 67.35%, si e keni gjet këtë përqindje? Tek niveli i Bordit po shkruan se janë 5 pozita të aprovuara me ligjin për buxhetin e vitit 2017, 5 pozitat janë të plotësuara dhe sa është totali i pagesave i cili nuk është shënuar? Nuk është i shënuar fare totali i pagesave shtesë për vitin 2017, mua më intereson a keni pas shtesa dhe sa për secilin nivel të të punësuarish?

Valon Prestreshi – në pyetjen e zotit Osmani, ashtu është një kontratë e tillë që është lidhur 10 vite më parë nga shteti dhe nuk ka bazë ligjore që të intervenohet. Tani se ka ardhur afati për ripërtirjen e kontratës ose për tu vendos diçka tutje rreth kësaj çështje, MI-ja e ka hartuar një udhëzim administrativ që ne kemi vlerësuar se është udhëzim i cili ç'rregullon konkurrencën.

Sa i përket të hyrave e vërteta është që ne me udhëzim administrativ kur kompanitë e blejnë njëra-tjetrën, tarifa është 3,000 euro dhe kjo është inkasim drejtpërdrejtë i Autoritetit që derdhet në Buxhetin e Shtetit, ndërsa te gjobat afërsisht 12 kompani janë dënua nga 100.000 euro që i bie 1.200.000 euro.

Akoma jemi nëpër gjykata duke u ballafaquar dhe ju njoftoj që shumicën e lëndëve jemi duke i humbur sepse ka mungesë të ditorisë së gjyqtarëve sidomos në fushën e konkurrencës.

Lidhur me pyetjen e zotit Hoti, ne kemi afat ligjor 10 muaj për me trajtu një çështje, ndërsa prej 2013-2016 nuk kanë qenë të plotësuar anëtarët e komisionit që janë vendimmarrës dhe administrata nuk ka kompetenca ligjore të merr vendim rreth kësaj çështje, mes atyre tre viteve që kanë kaluar, ju ka kaluar afati ligjor por ne kemi kërkuar nga kompanitë që a janë të interesuara që ta bëjnë riinicimin e lëndës.

Lidhur me pyetjet e ngritura nga znj. Hadërgjona, siç e tha edhe kryetari ndoshta nuk është dasht me potencu këtu është dasht me potensu tek Komisioni për Zhvillim Ekonomik, në raportin tonë të hulumtimit në nivel të Kosovës që e kemi pas edhe detyrë nga Komisioni Evropian i kemi cek të gjitha kompanitë dhe këto 13 tregje të cilat marrin pozita dominuese. Po ka monopol, monopoli më i pastër është i homologimit ka edhe tjerë që janë të pasqyruara në raport. Sa i përket shpenzimeve për pagat dhe mëditjet e Bordit ose Komisionit janë të përcaktuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, janë fikse nuk ka kurrëfar shtese. Kryetari e ka pagën 1,014 euro, anëtarët e komisionit 935 euro.

Safete Hadërgjonaj - unë po du me besu që ashtu është sepse me paga edhe nuk mund të bëhen lëvizje të shumëta me përjashtim me ndonjë shkelje që mund të bëhet eventuale, mirëpo ka qenë mirë me i pasqyru në raport, sipas niveleve të të punësuarëve. Këtë përqindje që e keni paraqitur tek “shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve”, është mirë të përmirësohet, që raporti mos të shkojë me gabime në seancë.

Kryetari - me kërkesën e komisionit që AKK-ja, të bëjë përmirësimet teknike në përqindjen për shpenzimet për shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve dhe tabelat tjera dhe të sjellni raportin e përmërisuar në Komision, rekomandoj të votohet ky raport.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin Vjetor Financiar të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017

Kryetari - fjalën ja kaloj zotit Ramadan Gashi të na prezentojë me raportin financiar të ANJF për vitin 2017.

Ramadan Gashi – foli për organizimin dhe funksionimin e ANJF-së. Sa i përket buxhetit mendoj se kryesisht kemi bërë shpenzimet sipas planifikimit, por ne gjithmonë ballafaqohemi me mungesë të buxhetit. Në rend të parë kemi mungesën që përveç zyrave rajonale duhet të kemi edhe zyrat mobile që do të thotë se duhet të kemi zyrtar të cilët mund t'i dërgojmë në zyra tjera dhe asnjëherë nuk kemi arrit me marrë këtë mbështetje dhe faktikisht qytetarët e komunave tjera kanë të drejtë me shfrytëzu ndihmën juridike falas dhe vetëm nëse paraqiten në zyre. Sa i përket këtij buxheti që e kemi për 7 zyre që funksionojnë dhe për çdo vit hyjmë nga 10.000 euro ose më shumë në borxhe. Kemi pas planifikim 52.000 euro për avokat por deri në fund të vitit ka arrit deri në 73.000 euro dhe ne me rishikim dhe vazhdimisht me anë të kursimeve tjera kemi arrit me i pagu 73.000 euro të viteve të kaluara dhe kemi hyrë në borxh këtë vit prej 10.000 euro, dhe realisht tani në Prill e kemi konsumuar buxhetin e 6 mujorit. Ne kemi pas 7000 lëndë ku 3500 prej tyre janë kryer .

Kryetari - sa bëhet fjalë për buxhet vjetor për këto shtesa që i kërkoni , a janë veç një herë që kërkohen paratë apo vazhdimisht ?

Ramadan Gashi - do të duhet të jetë financim i vazhdueshëm, dhe me 150.000-170.000 euro në komplotohemi një herë e përgjithmonë.

Kryetari – zoti Gashi krejt çka mundem me ju premtu është që kur të vjen rishikimi buxhetor do t'iu ftojme në një takim dhe bashkë me Ministrin do ta shqyrtojmë dhe më pas do t'i shohim mundësitë. Kam një pyetje, Fehim Osmani është kryesues i këshillit, pse nuk ka ardhur sot ai në takim?

Ramadan Gashi – sqaroi se zoti Fehimi nuk ka pasur mundësi të jetë i pranishëm dhe na ka autorizuar ne për prezantimin e raportit.

Kryetari – si është e mundur që ja keni qëlluar udhëtimeve zyrtare me cent?

Daut Morina – sqaroi se ne kemi respektuar udhëzimin administrativ të Ministrisë së Financave për raportim pesë shifrorë, prandaj edhe janë përputhur planifikimi me realizimin e shpenzimeve.

Safete Hadërgjonaj - ne nganjëherë kur po na dalin pagat me cent të shpenzuara po i arsyetojmë disi por këto me të udhëtimeve po na befasoni. Tek raporti financiar unë jam në dijeni për vështirësitë, mënyrën se si keni funksionu, si janë financuar zyret rajonale nga donatorët, megjithatë ne kemi bërë përpjekje aq sa kemi pas mundësi brenda buxhetit të bëhet rregullimi, mirë që është funksionalizu ato dy zyre për të cilat keni pas problem. Dua të ndalem tek raporti financiar i keni shënuar shifrat, ku ne e presim raportin e auditorit për me qartësuar se a janë shifrat reale apo i keni shënuar vetëm sa me i plotësu numrat, ndoshta edhe i verifikon edhe shpenzimet që janë dalë me cent për udhëtimet zyrtare , mëditjet, akomodimet e të tjerat, mirëpo këtu e kemi “shpenzimet e udhëtimit” pa shifër dhe nëntotali duhet me plotësu me një shifër si dhe tek “shërbimet e telekomunikimit”, prap se keni shënuar shifrën? Po ashtu tek qiraja e ndërtesës jam e interesuar të di a paguani qira vetëm për Prishtinë apo edhe ndonjë zyre regjionale dhe për zyret regjionale kush ju paguan shpenzimet?

Ramadan Gashi – sqaroi se në Pejë, Prizren dhe Gjilan jemi në objektet e prokurorisë, në Mitrovicë jemi në objektin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kurse në Ferizaj jemi në objekte të Komunës.

Safete Hadërgjonaj - tek lista e pagave, te niveli i bordit, në fund të raportit, nuk ka shuma fare se sa janë planifikuar dhe si janë shpenzuar mjetet. Kërkesa ime është të sjellni një raport të përmirësuar, të bëni korigjimet që përmendem dhe të specifikoni buxhetin për paga dhe shtesat eventuale sipas nivelit të të punësuarve, siç kërkohet në formular/

Kryetari – pyeti, përveç rrogës a merrni diçka tjetër ?

Ramadan Gashi – theksoi se përveç pagës, nuk marrim shtesa tjera.

Kryetari – rekomandojë që Komisioni të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjensisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017, me kushtëzimin që Agjencia të bëjë korigjimet dhe plotësimet që u paraqitën nga Znj. Hadërgjonaj.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin Vjetor Financiar të Agjensisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2017.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimeve Civil të Kosovës për vitin 2017

Kryetari - Fjalën ja kaloj Kryesuesit të Këshillit zotit Manaj që të na bëjë një prezentim të shkurtë për raportin financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për vitin 2017.

Shkëmb Manaj - në bazë të ligjit për buxhet, Këshilli ka pas të aprovuara 372.734 euro. Sipas kategorive ekonomike për paga dhe mëditje ka pas të planifikuara 236.507 euro, me rishikim nuk ka pas ndryshim të kësaj gjendje, në mallra dhe shërbime ka pas të aprovuar 107.402 euro, ndërsa me rishikim të buxhetit janë shtuar rreth 10.000 euro totalisht janë bërë 117.358 euro, ku kjo ngritje prej 10.000 euro ka ndodh për shkak se 9.000 euro janë bartur nga kategoria e kapitaleve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe 956 euro janë bartur nga kategoria e komunaleve. Tek shpenzimet komunale kemi pas të aprovuara 3,825 euro, ndërsa në rishikim kjo është zvogluar për 956 euro dhe mbet në total 2,869 euro, ndërsa shpenzimet kapitale kemi pas të aprovuara 25.000 euro, me rishikim të buxhetit kanë mbetur 16.000 euro, sepse janë bartur tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 16.000 euro në fund të vitit 2017 janë marrë nga Qeveria e Kosovës. Sa i përket shpenzimeve, në kategorinë paga dhe mëditje janë shpenzuar 236.594 euro, në kategorinë mallra dhe shërbime janë shpenzuar 99.490 euro, në kategorinë shpenzime komunale janë shpenzuar 2,717 euro dhe totali i buxhetit është 94.97%.

Kryetari – pyeti për udhëtime zyrtare jashtë vendit si dhe dreka i keni 100% të realizuara sa kanë qenë të planifikuara, më intereson të dijë si e keni ditur një vjet përpara sa keni me i shpenzuar paratë për dreka zyrtare me 5 euro diferencë? Dhe e dyta si e keni ditur një vjet përpara që keni me udhëtu për 0.10 cent diferencë prej planifikimit? Pse është shtuar për dyfish mëditja zyrtare në krahasim me vitin paraprak, pse është shtuar trefish shpenzimet për akomodim krahasuar me vitin paraprak, dhe pse janë shtuar pesëfish më shumë shpenzimet e tjera të udhëtimeve zyrtare?

Shkëmb Manaj – sa i përket drekave zyrtare është kategoria e reprezentacionit që është e planifikuar me vendim të paraparë të Këshillit. Vendimi i Këshillit e ka të planifikuar që Kryetari i Këshillit ka 100 euro reprezentacion gjatë muajit dhe kjo është në bazë të kontratës që e kemi të lidhur me byfenë.

Kryetari - ju jeni duke thënë se ai gjithsesi duhet me i shpenzu 100 euro me patjetër jo më pak? Bëjë apel të keni kujdes me këtë formë të shpenzimit.

Miran Zeneli - sa i përket udhëtimeve zyrtare ne kemi një plan vjetor të punës së Këshillit i cili në fillim të vitit planifikohet se çka ka nevojë Këshilli dhe për ato parashihet një pjesë e caktuar e mjeteve financiare.

Kryetari - shumë e paarsyeshme është kjo çështja e drekave, ju njoftoj që në rishikim të buxhetit do të propozoj amendamente për ndryshimin e këtyre shumave.

Shkëmb Manaj - pse janë rritur udhëtimet zyrtare , kjo ngritje ka qenë kërkesë e Kuvendit të Kosovës që Këshilli me i monitoru ambasadat dhe prandaj buxheti është rritur nga Qeveria edhe nga Kuvendi.

Safete Hadërgjonaj - tek tabela e struktures së pagave po e shoh që me vendim të Qeverisë janë bërë disa rritje, ju e keni specifikuar shumë mirë si pagesa shtesë, më intereson me ditë a ka qenë ky vendim i Qeverisë vetëm për institucionin e juaj apo ky vendim në bazë të cilës i ka përfshi edhe institucionet tjera?

Shkëmb Manaj – sqaroi se Vendimi i Qeverisë është aipër ngritjen e 30% të pagave që është nxerr për gjithë nënpunësit e Republikës së Kosovës dhe në bazë të kësaj është ajo shtesa 30 euro. Po ashtu e kemi

një vendim të Qeverisë që është nxerrur vetëm për KPM-në nëse nuk gaboj rreth 4,000 euro shtesa të cilat janë për zyrtarët që i kryejnë punët e financave. Ky vendim është që tri vite. Pra ideja ka qenë ose të shfaqim kërkesa për shtesë të stafit ose të marrim shtesa për këto punë.

Fikrim Damka - mua më intereson tek tabelat ku e kemi cek 9,000 euro për makineri, çfarë janë këto makineri - veturat?

Shkëmb Manaj - tek kapitalet e kemi pas të aprovuar shumën 25.000 euro për blerjen e dy veturave zyrtare, por ka qenë një vendim i Qeverisë që veturat të merren me qira prej Administratës Publike dhe ne e kemi zbatuar këtë vendim në konsultim me Ministrinë e Financave, jemi tërheq nga blerja e këtyre dy veturave dhe kemi marrë veturat me qira. Pra 9,000 euro prej këtyre 25.000 euro janë bartur në mallra dhe shërbime për me i pagu veturat që i kemi në shërbim.

Pas përfundimit të diskutimeve, konstatoj se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin Vjetor Financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2017.

5. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017

Kryetari – kërkojë nga sekretari të prezatojë raportin e shpenzimeve të Kuvendit 2017.

Ismet Krasniqi - theksoi se në bazë të raportit financiar, në vitin 2017, shpenzimi i buxhetit të Kuvendit në total është 90,79%. Siç shihet për paga dhe mëditje kemi shpenzuar 95.67%, mallra dhe shërbime 77.24%, shpenzime komunale 82%, subvencione dhe transfere 83.24%, ndërsa shpenzimet kapitale janë realizuar rreth 30%. Në vazhdim përmendi të gjitha projektet kapitale të planifikuara dhe nivelin e shpenzimeve të tyre si dhe për arsyet që kanë ndikuar në nivelin e ultë të realizimit të projekteve kapitale dhe për shkak të procedurave të prokurimit dhe dështimit të tenderëve. Kjo ka bërë që disa projekte të vazhdojnë edhe në vitin 2018.

Enver Hoti - pyeti për dreka zyrtare dhe udhëtime zyrtare jashtë vendit, kemi rritje të shpenzimeve krahasuar me vitin 2016? Po ashtu të na sqaroni për nivelin e ulët të shpenzimeve kapitale të cilat po përsëriten vazhdimisht?

Naser Osmani – theksoi se shpenzimet e fotokopjes janë të mëdha dhe unë rekomandojë që të shikohet mundësia e zëvendësimit të letrës me ndonjë program përmes internetit, pasi që qasja tek materialet është më e lehtë dhe më e shpejtë?

Kryetari - pyeti dhe kërkoi sqarime për disa shpenzime si në vijim: për shpenzimet për sigurimin e ndërtesës? për shpenzimet e naftës që janë më të larta krahasuar me vitin paraprak? për drekat zyrtare në shumë prej 116.000 euro? si dhe kërkoi sqarim se çfarë janë shpenzimet kontraktore?

Ismet Krasniqi – sqaroi se sa i përket shpenzimeve të naftës ne jemi të lidhur edhe me ngrohtoren e qytetit. Lidhur me zëvendësimin e letrës me formën e komunikimit përmes internetit, na duhet një konfirmim nga Grupet Parlamentare, që pastaj ne si Administratë të mund ta implementojmë. Sa i përket shpenzimeve kontraktore ka të bëjë me auditimin e subjekteve politike në shumë prej 30.000 euro.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin Vjetor Financiar të Kuvendit për vitin 2017.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për Liritë Fetare dhe amendamenteve të komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryetari - theksoi se në bazë të deklaratës financiare nga Ministria e Financave, projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore, po ashtu as amendamentet e Komisionit Funksional nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas sqarimeve, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

Projektligji Nr.06/L-001 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-31 për Liritë Fetare, dhe amendamentet të komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione, nuk përmban kosto buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën dhe amendamenteve të komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media

Kryetari - theksoi se projektligji ka kosto shtesë buxhetore. Por duke e ditur rëndësinë që ka miratimi i këtij ligji në interes të kryeqytetit, mendon se duhet ta përkrahim dhe ta procedojmë më tutje me dhe kostoja buxhetore duhet të planifikohet në proceset e ardhshme buxhetore. Amendamentet e komisionit funksional nuk kanë kosto shtesë buxhetore, ndërsa amendamentin që e kam propozuar unë ka të bëjë me rritjen e grantit të përgjithshëm nga 4% në 6%, përmban kosto shtesë por që duhet të trajtohet së bashku me koston për zbatimin e ligjit.

Pas përfundimit të diskutimit, kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë :

Rekomandim

1. Projektligji Nr.06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, përmbanë kosto të përballeshme buxhetore për Republikën e Kosovës.
2. Amendamentet e komisionit funksional për Administratë Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media, nuk përmbajnë kosto buxhetore shtesë.
3. Amendamenti i propozuar nga deputeti Lumir Abdixhiku, përmban kosto të përballeshme buxhetore për Republikën e Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetari komisionit,

Lumir Abdixhiku